



NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturinat Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut (KRRE) solli vendimin, me të cilin bëhet **rritja** e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës, mesatarisht **1,47 %** në raport me vendimin e datës 29.6.2026.

Çmimet referente të derivateve të naftës në tregun botëror, në krahasi me përlogaritjen e mëparshme shënojnë rritje të benzina mesatarisht 2,576%, të nafta rritja është mesatarisht 5,201%, të vaji ekstra i lehtë rritja është mesatarisht 4,681% dhe të mazuti ulja është mesatarisht 0,967%.

Kursi i denarit në raport me dollarin në periudhën e kaluar, sipas të cilit janë formuar çmimet në përlogaritjen e mëparshme, është më i lartë për **1,5132%**.

Nga data 7.7.2026, nga ora 00:01, çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	85,50 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	87,50 (denarë/litër)
- Naftë motori - EUROIDIZEL BS (D-E V)	-	82,50 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	81,50 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	41,230 (denarë/kilogram)

Çmimi i shitjes me pakicë i **EUROIDIZELIT (D-E V)** rritet për **2,50 den/litër**.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinave **EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98** rriten për **1,00 den/litër**.

Çmimi i shitjes me pakicë i **Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1)** rritet për **2,00 den/litër**.

Çmimi i shitjes me pakicë i **Mazutit M-1 SU** ulet për **0,265 denarë/kg**.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 7.7.2026. Tregtarët me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës dhe të karburanteve për transport mund të vendosin çmime të veçanta për derivatet e naftës dhe të karburanteve për transport edhe më të ulëta se çmimet më lartë të përcaktuara.

6.7.2026